



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:046932

Datë: 10.09.2024

Numri i dokumentit: 06142636

C.nr.388/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu, në çështjen juridike të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(KEDS), me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, nr.5, Ndërtesa Elektrokosovës, Kati II, nr.5, kundër të paditurit Sh.R. nga Ferizaj, rruga R.Sh. p.nr., në çështjen juridike kompensim i dëmit, jashtë seancës, me datë 10.09.2024, merr këtë;

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(KEDS), me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Sh.R. nga Ferizaj, në çështjen juridike kompensim i dëmit.

A r s y e t i m i

Paditësja KEDS me seli në Prishtinë, më datë 12.03.2021, ka paraqitur padi kundër të paditurit Sh.R. nga Ferizaj, për kompensim i dëmit.

Gjykata gjatë shqyrtimi paraprak të padisë ka hasur në të meta në padi, për çka nuk ka mundur të vazhdoj tutje me procedim të çështjes, ku me aktvendimin e datës 05.04.2024, paditëses ja ka kthyer në plotësim padinë, duke e njoftuar me pasojat juridike në rast të mos veprimit sipas udhëzimeve nga gjykata.

Gjykata pas shiqimit të shkresave të lëndës, vlerëson se paditëses më datën 17.04.2024, i është dorëzuar aktvendimi dhe me qenë se pala paditëse në afatin e caktuar nga gjykata nuk e ka plotësuar dhe përmirësuar padinë sipas aktvendimit të lartë cekur, në pajtim me nenin 102.3 të LPK-së, padinë e paditëses e konsideron si të tërhequr.

Andaj nga të theksuarat më lartë, mbi këtë arsye, bazuar në nenin 102 par 3, lidhur me nenin 387 par.1 pika (c) i LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.388/21, me datë 10.09.2024

**Gjyqtari,
Bekim Salihu**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.